

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
NDËRMJET AUTORITETIT TË KONKURENCËS DHE KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIO -
TELEVIZIONIT

Ky Memorandum lidhet midis:

Autoritetit të Konkurrencës, i njohur më poshtë si “Autoriteti”, i përfaqësuar nga titullari i tij, kryetare znj.Lindita Milo (Lati), që është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, është organ publik i pavarur në kryerjen e detyrave të veta. Autoriteti monitoron rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën, në përputhje me ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;

dhe

Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit i njohur më poshtë si “KKRT”, i përfaqësuar nga kryetari z. Ledi Bianku, dhe që është organizëm i pavarur, i cili vepron në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë.

Neni 1
Rëndësia

Duke qenë se:

- konkurrenca e lirë në një treg të caktuar udhëhiqet nga parimi i mundësive për zgjedhje më të mira për konsumatorin, nga suksesi në treg në përputhje me këto zgjedhje;
- pluralizmi në media, parimi themelor i lirisë së ushtrimit të këtij aktiviteti, bazohet para së gjithash në situata konkurrenciale të rregulluara me ligj, ku askush të mos ketë mundësi t’i imponojë mendimin e tij tjetrit, qoftë edhe duke përfituar nga situata antikonkurrenciale ose monopol;
- fusha e politikave audio-vizuale ka një rëndësi të veçantë në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, për shkak të detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit;
- angazhimet e marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit synojnë, ndërmjet të tjerash, garantimin e konkurrencës në tregun e rrjeteve të komunikimit dhe shërbimeve në përputhje me rregullat e konkurrencës që zbatohen nga Komuniteti, si dhe harmonizimin e legjislacionit në këtë fushë me *acquis communitaires*;
- fusha e mediave elektronike ka pësuar zhvillime të qenësishme vitet e fundit në kuadrin e reformimit thelbësor, që synon ndërtimin e një ekonomie të tregut konkurrues në këta sektorë dhe aktualisht ndodhen në një fazë zhvillimi të veçantë, në një mjedis ekonomik të favorshëm;
- KKRT-ja në fushën e mediave elektronike po luan gjithnjë e më shumë një rol më të dukshëm në jetën ekonomike të vendit dhe pritet së afërmi një kontribut edhe më i madh, si rrjedhojë e zhvillimeve të rëndësishme teknologjike dhe ekonomike në fushën e transmetimeve televizive;
- interesi publik për stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e fushës së mediave elektronike mbetet i veçantë edhe për shkak të problematikës që ka pasur kjo fushë në të shkuarën;
- treguesit e konkurrencës në fushën e mediave elektronike dëshmojnë problematikën e fazës në të cilën ndodhet ai, ku ka zotërim të tregut nga operatorë të veçantë për shkak të strukturës së tij para privatizimit dhe fragmentarizim të tregut nga pikëpamja e moskonkurrimit të një numri të përshtatshëm operatorësh në fushën e mediave elektronike dhe në çdo segment të saj;
- ekzistojnë barriera ligjore, publike e private për investitorët që kërkojnë të hyjnë në këta sektorë;
- Autoriteti dhe KKRT-ja kanë përgjegjësinë ligjore për mbrojtjen e operatorëve dhe konsumatorëve nga veprimet abuzive në tregun e mediave elektronike dhe për garantimin dhe zbatimin e rregullave të konkurrencës në këtë fushë.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për një konkurrencë të lirë dhe efektive në fushën e mediave elektronike.

Neni 3 **Baza ligjore**

Ky Memorandum bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (veçanërisht neni 70), si dhe në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 7 pika 4 dhe 137/5).

Neni 4 **Forma e bashkëpunimit**

Palët bien dakord si më poshtë:

1. Institucionalizohet, sipas këtij Memorandumi dhe akteve të tjera të nevojshme të pranura nga palët, bashkëpunimi reciprok në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjella në sferën e forcimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në fushën e mediave elektronike.

2. Palët do të bashkëpunojnë për të bërë studime tregu lidhur me gjendjen e konkurrencës dhe me propozimet për rregullimet ligjore e nënligjore për të përmirësuar situatën aktuale në këtë treg lidhur me treguesit e konkurrencës.

3. Autoriteti bashkëpunon për rritjen e një konkurrence të lirë dhe efektive duke dhënë dhe mendimet e tij në rastet e kufizimit, ndërhyrjes dhe deformimit të tregut në fushën e mediave elektronike.

4. KKRT-ja angazhohet për rivlerësimin e akteve normative e jonormative të hartuara prej tij, duke synuar përmirësimin e standardeve dhe kushteve për një konkurrencë të lirë dhe efektive në sektorët përkatës, në përputhje me standardet europiane në këtë fushë.

5. Të gjitha aktet ligjore, normative e jonormative që do të hartohen, në lidhje me operatorët e kësaj fushe dhe që referojnë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin e produkteve dhe shërbimeve dhe ekskluziviteteve për veprimtari të caktuara, imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushte të shitjes etj., do të konsultohen paraprakisht me Autoritetin me qëllim garantimin e standardeve për një konkurrencë të lirë dhe efektive.

6. KKRT-ja angazhohet që të mos përdorë mekanizma të mbikëqyrjes (rezerva, garanci, madhësi të shërbimeve të ofruara apo të furnizuara, nivel likuiditeti etj.), që diskriminojnë apo favorizojnë operatorë të veçantë që veprojnë në treg.

7. KKRT-ja bie dakord që, duke mos mënjanuar interesin publik të sektorit, të fillojë procesin e liberalizimit dhe përafrimit gradual me standardet europiane, të procedurave të licencimit, të kërkuara për hyrjen në tregun e mediave elektronike, të kufizimeve penguese të tyre, si dhe të treguesve të mbikëqyrjes duke eliminuar praktikatat administrative që dëmtojnë konkurrencën.

8. KKRT-ja angazhohet që, në veprimtarinë e saj mbikëqyrëse dhe rregulluese të operatorëve të licencuar prej saj, si dhe në procesin e miratimit të licencave të reja dhe në bashkimet e mundshme të këtyre operatorëve, të respektojë rregullat e konkurrencës për të mos lejuar operatorë me pozicion zotërues në treg, të mbulojë gjithë territorin e tregut të brendshëm me operatorë konkurrentë në tregtimin e shërbimeve.

9. Në mënyrë të veçantë, KKRT-ja, përmes mbikëqyrjes së kushteve të tregtimit të shërbimeve, do të synojë:

a) ndalimin e kufizimeve horizontale të konkurrencës nëpërmjet kontratave të përbashkëta (çmimet e shërbimeve, territorin e tregjeve etj.);

b) ndalimin e kufizimeve vertikale të konkurrencës (diskriminim për klientë të ndryshëm në të njëjtin treg, diskriminimi i kufizimeve dhe kërkesave specifike për garanci e kushte të tjera për klientë me kushte të njëjta në të njëjtin treg etj.).

10. Autoriteti dhe KKRT-ja do të publikojnë dhe/ose shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet ku bazohet ky Memorandum, duke respektuar

në rast nevoje karakterin e tyre konfidencial, dhe që kanë të bëjnë me problemet e konkurrencës në fushën e mediave elektronike.

11. Secila prej palëve do të emërojë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, sipas formave që përcaktohen nga ky Memorandum.

Neni 5

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Ky Memorandum nënshkruhet sot më datë 5.12.2006 në dy kopje origjinale. Memorandumi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PËR AUTORITETIN E KONKURRENCËS PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË RADIOS
DHE TELEVISIONIT

KRYETARI
Lindita Milo (Lati)

KRYETARI
Ledi Bianku